



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:226100

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830167

Ac.nr.9908/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.O. nga P....., rr....., të cilin e përfaqëson me prokurë Jeton Osmani, avokat në Prishtinë, kundër të paditurve: 1. M.K. nga fsh....., P....., me vendbanim rr....., 2. Korporata Energjetike e Kosovës- KEK sh.a. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me prokurë Shukrije Miftari dhe 3. Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me prokurë Naim Krasniqi nga Avokatura shtetërore, për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të paditësit të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.508/18, i datës 23.07.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit A.O. nga P....., rr....., **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.508/18, i datës 23.07.2021 në piken I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë në raport me të paditurin M.K. nga fsh....., P..... dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: **APROVOHET** pjesërisht si bazuar kërkesëpadia paditësit A.O. nga P....., rr..... **DETYROHET** i padituri: M.K. nga fsh....., P....., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material, të shkaktuar si pasoj e sulmit të datës 20.02.2013, të ia paguaj shumat si në vijim: **Në emër të dëmit jo material:** Për dhimbje fizike trupore shumë prej 1500 euro; Për friken e pësuar shumë prej 1200 euro; **Në emër të dëmit material:** Për kujdesin e huaj shumë prej 10 euro, Për ushqim të përforcuar shumë prej 140 euro dhe atë me kamatë ligjore 8 %, duke filluar nga data 23.07.2021, e gjerë në pagesën definitive, si dhe **DETYROHET** e paditura që, paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej **964 euro**, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, ndërsa pjesa e kërkesëpadisë së paditësit për dëmin mbi shumë e gjykuar dhe atë, në emër të dhimbjeve fizike shumë prej **1500 euro**, në emër të frikës së pësuar shumë prej **1800 euro**, në emër cenimit të autoritetit shumë prej **3000 euro**, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej **360 euro**, në emër të kujdesit të huaj shumë prej **290 euro**, **REFUZOHET SI E PA BAZUAR.**

II. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit: A.O. nga P....., rr....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.508/18, i datës 23.07.2021 në piken I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë në raport me të paditurat Korporata Energjetike

e Kosovës- KEK sh.a. me seli në Prishtinë dhe Qeveria e Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës me seli në Prishtinë, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.88/2017, i datës Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.508/18, i datës 23.07.2021 ka vendosur si në vijim:

I- REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.O. nga P....., me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit M.K., Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë dhe Policia e Kosovës, që paditësit për të gjitha format e dëmit material dhe jomaterial të pësuar për shkak të lëndimit nga aksidenti me dt. 20.2.2013, t'ia dëmshpërblejnë në mënyrë solidarë shumën e përgjithshme prej 9,800.00€, me kamatë prej 8%, nga dita e lëndimit me dt. 20.02.2013 deri në pagesën definitive, dhe atë: në emër të frikës së përjetuar 3,000.00€, në emër të dhimbjeve fizike 3,000.00€, në emër të cenimit të autoritetit dhe nderit 3,000.00€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj 300.00€, si dhe në emër të ushqimit të përforcuar 500.00 €.

II- Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e paditësit si e bazuar dhe gjykata e shkallës së dytë ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë apo ta ndryshoj lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura e dytë KEK-Sh.a, me propozim që të refuzohet ankesa e paditësit ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vertetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës se dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 20.02.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, të precizuar si në parashtresën e datës 12.05.2021, me të cilin ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe të detyrohen të paditurit M.K., Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë dhe Policia e Kosovës, që paditësit për të gjitha format e dëmit material dhe jomaterial të pësuar për shkak të lëndimit nga aksidenti me dt. 20.2.2013, t'ia dëmshpërblejnë në mënyrë solidarë shumën e përgjithshme prej 9,800.00€, me kamatë prej 8% nga dita e lëndimit me dt. 20.02.2013 deri në pagesën definitive, dhe atë: në emër të frikës së përjetuar 3,000.00€, në emër të dhimbjeve fizike 3,000.00€, në emër të cenimit të autoritetit dhe nderit 3,000.00€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj 300.00€, si dhe në emër të ushqimit të përforcuar 500.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.88/2017, i datës 05.02.2019, me

të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin të të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.508/18, i datës 23.07.2021, me të cilin ka refuzuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Pas shqyrtimit dhe vlerësimin të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara një nga një dhe të gjitha së bashku, sipas dispozitës së nenit 8 të LPK- së, gjykata gjeti se padia dhe kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e pabazuar, ndaj dhe të njëjtën e refuzoi për shkak të parashkrimit të kërkesës së paditësit, sipas dispozitës së nenit 357 par. 1 të LMD-së. Nuk është kontestuese që paditësi me dt. 20.02.2018 ka paraqitur padi në gjykatë me kërkesë për kompensimin e dëmit material dhe jomatreal për shkak të sulmit fizik të paditurve ndaj paditësit, me dt. 20.02.2013 në shtëpinë e të paditurit të parë M.Kme rastin e shkyqjes së rrymës elektrike.

Tutje gjykata ka shtuar se sipas dispozitës së nenit 357 par.1 të LMD-së parashikohet që kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet në afat prej 3 vjet nga dita kur i dëmtuari- paditësi ka marrë dënimin për dëmin dhe personin i cili e ka shkaktuar dëmin. Në rastin konkret dëmi është shkaktuar me dt. 20.02.2013, ndaj gjykata gjeti se paditësi A.O. ka mësuar për dëmin dhe shkaktarin e dëmit menjëherë në momentin e shkaktimit të dëmit. Paditësi pretendon se ka pësuar dhe lëndime nga ky sulm, ndërkaq i njëjti padinë e ka paraqitur në gjykatë me dt. 20.02.2018. Gjykata vlerëson se nga dt. 20.02.2013 deri me paraqitjen e padisë në gjykatë me 20.02.2018 kanë kaluar më tepër se 3 vjet, për çka dhe ka ardhur deri te parashkrimi i kërkesës së paditësit. Ndaj dhe gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke u bazuar në këtë dispozitiv ligjorë të theksuar. Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitivin nga neni 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, mirëpo sipas gjykatës së shkallës së dytë, gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat e lëndës, ku për pasojë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimin ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar, me çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, për çka u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sipas Gjykatës së Apelit, me shikimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, rezulton se i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me kusht, fakt ky i vërtetuar me aktgjykimin penal të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.162/2014, i datës 13.05.2016, i cili ka marrë formën e prerë me datë 06.06.2016, për shkak të veprës penale të sulm ndaj personit zyrtar nga neni 410 par.1 i KPRK-së, ashtu që është vërtetuar se me dt.20.02.2013 rreth orës 12:45, në P....., rr....., përderisa zyrtari i KEK-ut, tani i dëmtuari A.O. ishte në kryerjen e detyrës zyrtare lidhur me çkyqjen nga rrjeti elektrik, të të pandehurit i cili nuk kishte paguar energjinë elektrike, i pandehuri me të kuptuar këtë , në shenjë revolte, fillimisht fyen zyrtarin e

KEK-ut e pastaj e sulmon fizikisht të njëjtin , duke e goditur me grushta dore në kokë në anën e majtë, në prezencë të policisë. Duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, ku gjate arrestimit të tij nga ana e policisë i njëjti ka rezistuar arrestimit, ku pëson lëndime të lehta trupore edhe zyrtari policor tani i dëmtuari Sh.E..

Gjykata e Apelit nga provat që janë administruar ne gjykatën e shkallës së parë ka vertuar ketë gjendje faktike, se në bazë të provave të administruara gjykata e shkallës së parë, baza e kërkesëpadisë është vërtetuar përmes aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës penale me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor, P.nr.162/2014, i datës 13.05.2016, në bazë të të cilëve udhëzohet pala e dëmtuar këtu paditësi A.O. që të realizoj kërkesën pasurore juridike përmes kontestit në rregullt civil. Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr. V.B.ortoped traumatolog dhe Dr.F.K.psikiatër, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit e drejtpërdrejt të paditësit kanë dhënë mendimin dhe konstatimin profesional në bazë të të cilit është konstatuar se paditësi-pacienti nga në incidentit e dt.20.02.2013 ka pësuar lëndime të lehta trupore ndrydhje e veshit të majtë, ndrydhje e regjionit temporal të majtë, nga të cilat ka përjetuar dhembje fizike të intensitetit të rend rreth 24 orë, me vonë të shoqëruara me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh, me pas kanë pësuar me intensitet të ulët në kohëzgjatje prej 2 jave. Nga lëndimet brenda të sipër theksuara i dëmtuari-paditësi ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekondave, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 5 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 2 muajve e manifestuar me çrregullim të gjumit, disponim, riperjetime etj. , si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët zgjat ende, ndihmë e huaj ka qenë e nevojshme prej 24 ore, ushqim i përforcuar në kohëzgjatje prej dy jave, ku Gjykata e Apelit ekspertizat e lartë përmendur i mori në tërësi si të bazuara duke e dhënë besimin e plotë ngase e njëjta përmban element e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve në këtë çështje kontestimore.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëses, gjen mbështetje në nenin 136, 140, dhe 169, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012. , i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Me nenin 14 të LPK-së përcaktohet se: *“Në procedurën kontestimore Gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”*

Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjës për të kompensuar dëmin paditëses, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 169 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: *“ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”*, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: *“ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”*, me nenin 169 paragraf 1, përcaktohet se: *“ Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohej dëmi”*, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: *“ Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të jap shpërblimin në të holla ”*.

Me nenin 7, të LPK-së: *“ Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla ”*, ndërsa sipas nenit 319 të LPK-së, përcaktohet se: *“ Secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta ”*. Meqenëse i padituri i parë me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, andaj

gjykata e shkallës së dytë, duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit për kompensimin e dëmit.

Lidhur me pjesën e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jomaterial Për dhimbje fizike, gjykata ka caktuar shpërblimin për paditësin A.O. shumë prej 1500 euro, duke vlerësuar si shpërblim të drejtë që i shërben qëllimit të kompensimit të dëmit sepse paditësi sipas mendimit të eksperteve të mjekësisë si pasojë e aksidentit, ka pësuar lëndime të lehta trupore, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë në lartësi prej 1500 euro, gjykata e ka refuzuar, duke vlerësuar si shumë të lartë dhe jo në proporcion me dëmin e shkaktuar dhe një shumë e tillë e tejkalon qëllimin e shpërblimit të dëmit. Për frikë, gjykata ka caktuar shpërblimin për paditësin, në shumë prej 1200 euro, duke pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës që nënkupton friken rreth procedurave mjekësore, friken rreth pasojave të mundshme, ashtu që gjykata vlerëson se shuma e lartcekur është e drejtë dhe i shërben qëllimit të kompensimit të dëmit, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë në lartësi prej 1800 euro, gjykata e ka refuzuar pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Për ndihmën dhe përkujdesjen e personit të huaj, gjykata ka caktuar shpërblimin për paditësin në shumë prej 10 euro, duke e pasur parasysh se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të veçante për 24 orë, në kuptim të nevojave të përditshme jetësore, rreth veshmbathjes, ushqimit si dhe ndihma rreth trajtimit mjekësor, ashtu që gjykata vlerëson se shuma e lartcekur është e drejtë dhe e njëjta i shërben qëllimit të kompensimit, kurse pjesën tjetër të kërkesëpadisë në lartësi prej 290 euro, e refuzoj si të pa bazuar, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Për ushqim të përforcuar, gjykata ka caktuar shpërblimin për paditësin, në shumë prej 140 euro, duke e pasur parasysh faktin se në këtë aksident paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, dhe ka qenë pa dyshim e nevojshme që paditësi të përdor ushqimet e përforcuara me qëllim të rehabilitimit më të shpejtë dhe më të mirë, ashtu që gjykata vlerëson se shuma e lartcekur është e drejtë dhe e njëjta i shërben qëllimit të kompensimit, kurse pjesën tjetër të kërkesëpadisë në lartësi prej 160 euro, e refuzoj si të pa bazuar, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të shërbente qëllimit të kompensimit.

Për në emër cenimit të autoritetit, ku paditësi në emër të kësaj forme të dëmit kishte kërkuar shumën në lartësi prej 3000 euro, gjykata e refuzoi si të pa bazuar, për shkak se me asnjë provë nuk u vërtetua se i njëjti ka cenimit të autoritetit.

Pretendimi lidhur me parashkrimin e kërkesës se paditësit është i pabazuar, për arsye se rasti ka ndodhur me datë 20.02.2013, padia është paraqitur në gjykatë me datë 20.02.2018, ndërsa aktgjykimi penal P.nr.162/2014 i datës 13.05.2016, ka marrë formën e prerë me datë 06.06.2016, e nga kjo rezulton se nga momenti kur aktgjykimi penal ka marrë formën e prerë nuk ka kaluar as dy (2) vite, dhe se padia e paditësit është paraqitur brenda afatit ligjor, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit nuk është parashkruar për arsye se:

Me nenin 357 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili ka shkaktuar dëmin ”.

Me nenin 358 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kur dëmi është shkaktuar me vepër penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë i parashkrimit, kërkesa për shpërblimin e dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale ”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: “ Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale sjell edhe ndërprerjen parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit ”.

Me nenin 410 paragraf 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), përcaktohet se: “Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, gjyqtarin, prokurorin apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare lidhur me sigurinë e përgjithshme, sigurinë e Republikës së Kosovës apo ruajtjen e rendit publik, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.” Me nenin 106 paragraf 1 pika 5, të këtij kodi përcaktohet se: “ Ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kane kaluar afatet e mëposhtme: Tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim “, (parashkrimi relativ i ndjekjes penale). Ndërsa me nenin 107 paragrafi 8 te këtij kodi përcaktohet se: “ Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur te ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit ” (parashkrimi absolut i ndjekjes penale). Pra nga interpretimi i këtyre dispozitve ne rastin konkret nuk ka arritur afati i parashkrimit.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktgjyqi, Gjykata e Apelit nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes ka vërtetuar faktin se shkaktar apo përgjegjës kryesor dhe i vetëm i lëndimit të paditësit ka qenë i padituri i parë M.K., kjo vërtetohet me aktgjykimet lëshuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës P.nr.162/2014 datës 13.05.2016 i plotfuqishëm me dt.06.06.2016, e në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin e demit material dhe jo material për të cilin paditësi pretendojnë se shkaktar i demit janë edhe punëdhënësi i paditësit respektivisht Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë dhe Policia e Kosovës, sepse të njëjtat kanë përgjegjësi objekteve sepse nuk kanë siguruar ofrimin e sigurisë në punë. Gjykata e Apelit pretendimet e tilla nga ana e paditësit i refuzoi si te pa bazuara për faktin se bazuar ne shkresat penale është vërtetuar fakti se përgjegjës apo shkaktar i këtij demi është vetëm personi fizik dhe atë M.K., i cili është dënuar për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar nga neni 410 par.1 te KPRK, ndërsa me asnjë provë qe gjendet ne shkresa te lendes nuk është vërtetuar se ka lëshime nga të paditurat Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë dhe Policia e Kosovës. Duke qenë se u vërtetua se e paditura e dytë dhe e tretë ne rastin konkret nuk mban përgjegjësi për demin e shkaktuar, **të njëjta nuk kanë legjitimacion real pasiv** në këtë çështje juridike kontestimore, ngase siç edhe u cek më lartë, përgjegjës (fajtor) është shpallur kryerësi i veprës penale i padituri i parë M.K., andaj padia e paditësit për kompensim demi material dhe jo material, kundër të paditurave Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në Prishtinë dhe Policia e Kosovës, me të drejt është refuzuar si e pabazuar.

Vendimi sa i përket kamatës kjo gjykatë e ka bazuar me dispozitën nga neni 382 të LMD-së. Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur duke u bazuar në neni 452 paragrafi 1, i LPK-së, ndërsa lartësia e shpenzime i referohet përpilimit të padisë në shumë prej 104 Euro, për katër seanca për përfaqësim secilën nga 135 Euro, ekspertiza në shumë prej 300 Euro, dhe për taksa gjyqësore shuma prej 20 Euro.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 9908/2021, me datë 11.06.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v